

Procesverbal
Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Skrapar

Mbajtur më datë 28.08.2023

Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 11:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes: Salla e mbledhjeve e Këshillit të Bashkisë Skrapar , Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë, Mbledhje e radhës Këshillit të Bashkisë Skrapar, e hapur .

Listëprezenca e këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes,

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA
4. EDMOND KALEMI
5. ELSA PETRITAJ
6. ENVER CAKA
7. FIKRET TELHA m
8. LIRI NUHELLARI
9. MIMOZA HYSAJ
10. MIMOZA ZYLYFTARI
11. MYQERRET HEBIBASI
12. PËLLUMB GURI
13. SKERDILAJT JAUPLLARI
14. VALBONA GROPA m
15. ERALED ZAIMI

Sekretare e Këshillit deklaroi kuorumin prej 13 Këshilltarësh

Në mbledhje janë të pranishëm: Kryetari i Bashkisë Z. Adriatik Mema, përfaqësues të administratës të cilët kanë hartuar projektvendimet që do meren në shqyrtim.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes, duke kaluar në pikën 1, Miratimi i rendit të ditës, e cila deklaroi se me kerkese te kryetarit te bashkise projektvendimi “Per dhenien e ndihmes financiare familjes se Kristo Pasho Kono per demet ndertimore ne banese shkaktuar nga zjarri i dates 17.05.2023”, nuk do te meret ne shqyrtim per munges fondesh.

Me leje fjalen e mori Z. Myqerret Hebibasi i cili deklaroi se kemi nje rast ne Gurrazes qe i eshte djegur gjithëçka dhe blegtoria.

Fjalën e mori Kryetari i Bashkise i cili deklaroi se i jemi drejtuar Emergjencave Civile per shtes fondesh, pasi nuk kemi mjaftueshem fonde per te perballuar keto situata.

Me leje fjalen e mori Z. Pellumb Guri i cili deklaroi se eshte shume e rendesishme dhënia e ndihmes financiare ketyre familjeve, po sidomos familjes qe i eshte djegur dhe blegtoria.

Fjalën e mer Kryetare e Keshillit e cila kerkoj nga keshilltaret miratimin e rendit te dites.

Ka pyetje diskutime- jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës pa projektvendimin “Per dhënie e ndihmes financiare familjes se Kristo Pasho Kono per demet ndertimore ne banese shkaktuar nga zjarri i dates 17.05.2023”

Vota PRO: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka,

Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Liri Nuhellari, Albana Hoxha, Erald Zaimi,

Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari

Vota KUNDER: 1, Mimoza Zylyftari

Vota ABSTENIM : s’ka

Pika 2 e rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25. 07. 2023

Kryetare e këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve në se ka dikush për të shtuar ose hequr në lidhje me përmbajtjen e procesverbalit i cili i është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Këshilltarët shprehin dakordësi me përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme. Ora 11:10, Votimi i hapur

Vota PRO: 13, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka,

Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari,

Albana Hoxha, Erald Zaimi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDER: s’ka

Vota ABSTENIM : s’ka

Pika 3 e rendit të ditës Projektvendim, “Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2023”.

Kryetare e Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mer Znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektaktin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare e Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes

Me leje fjalën e mori Z. Pellumb Guri i cili kerkoi te informohet me menyren se si ushtrohen kontrollet ne familjet qe jane perfitues te ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, pasi kam vrejtur qe çdo muaj jane hequr familje nga skema e ndihmes.

Me leje fjalën e mer Znj. Teuta Hysenbelliu e cila sqaroi se kur nuk paraqitet kryefamiljari per te bere aplikimin, sistemi e perjashton automatikisht, ne si zyre i kemi njoftuar qe te paraqiten sepse ndodh qe harrojne, gjithashtu ne ushtrojme kontrole te here pas hershme ne familje se ndodh qe kryefamiljari eshte jashte shtetit edhe pse familja eshte ne gjendje te veshtire ekonomike nuk mund te futet ne skeme pasi perben shkelje ligjore.

Kryetare e Këshillit drejton pyetjen në se ka me pyetje diskutime rreth çështjes - jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit në orën 11:35, Votimi u bë i hapur

Vota PRO: 13, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka,

Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari,

Albana Hoxha, Erald Zaimi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDER: s'ka

Vota ABSTENIM : s'ka

Pika 4 e rendit të ditës Projektvendim, “Për një ndryshim në VKB- në Nr. 86, datë 21. 12. 2022, Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”, lidhur me disa transferime buxheti nga të ardhurat në nivel programi dhe artikulli për Bashkinë Skrapar dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”

Kryetare e Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori Z. Naim Gogo i cili prezantoi projektaktin sipas relacionit bashkëlidhur

Fjalën e mori Kryetari i Bashkisë i cili deklaroi se është shume e rendesishme rinovimi i kontratës me Kompanin “VOLTALI”, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor në fshatin Dobrenj, ku një pjesë e të ardhurave nga kjo kontrane do të përdoret për rehabilitimin e rrugës “Arkitekt Kasemi”, në segmentin nga ish-axhensia deri te lulishtja në lagjen “Hasan Seitaj”, ku do te perfshihet dhe sistemimi i sheshit para pallatit tek Qendra Shendetesore, si dhe prezenca e bizneseve anes rruges nga ura e vilave deri ne qender te qytetit dhe kjo do shikohet etj. Paraprakisht do të hartohet Projekti për këtë objekt investimi për të cilin kërkohen fonde buxhetore në vlerën prej 1,200,000 lekë. Për këtë arsye kemi bërë transferim buxheti nga të ardhurat për të mundësuar hartimin e projektit sa më parë që dhe punimet për rehabilitimin e këtij segmenti të nisnin sa me shpejt, per kete ju kerkoj miratimin nga ana juaj te ketij projektvendimi qe te nisi puna pasi eshte nje projekt qe do te kete ndikim te ndjeshem ne komunitet.

Kemi aplikuar dhe tek Fondi i Zhvillimit per keto segmente, ku kemi bere dhe nje kerkese qe bashkia te beje trotuaret dhe ndriçmin ne keto segmente.

Me leje fjalën e mori Z. Pellumb Guri i cili deklaroi se eshte me shume interes realizimi i ketij projekti.

Kryetare e Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes- Jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit në orën 11:45, Votimi u bë i hapur

Vota PRO: 13, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka,

Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari,

Albana Hoxha, Erald Zaimi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDER: s'ka

Vota ABSTENIM : s'ka

Pika 7 e rendit të ditës, te ndryshme

Kryetare e Këshillit ju drejtua keshilltareve duke kerkuar te bejne prezent shqetesimet e komunitetit qe perfaqesojne.

Me leje fjalën e mori Z. Enver Caka i cili shprehu mendimin qe te ftojme ne mbledhjen e keshillit deputetin e zones, beri present shqetesimin per Varrezat e Deshmorve, ku po afron dhe festa e çlirimit te Skraparit dhe nje pjese e emrave te deshmorve nuk lexohen te shikohet kjo. Fusha tek shkolla nuk po hapet qe te luajne femijet.

Fjalën e mori Kryetari i Bashkise i cili beri me dije keshilltaret se eshte ne kontakt te vazhdueshem me deputetin e zones dhe me drjtuesin politik te qarkut, te cilet jane ne dijeni te kerkesave qe kemi dhe po punojne per zgjidhjen e tyre dhe nuk jam ne nje mendim me ju per kete.

Per shqetesimin ne lidhje me emrat e te reneve, ato jane lare me solucion po do e shikojme qe te bejme me te mire.

Problemi pse nuk eshte hapur Qendra e re sportive të shkollës “Zylyftar Veleshnja” eshte se po zevendesojne tapetin i cili u demtua per shkak se u vu ne funksion pa u maturuar shtresa, do ti jepet hoha e duhur dhe seshpejti do te jete funksionale.

Me leje fjalën e mori Z. Arjan Hasa i cili shprehu shqetesimin per lyerjen dhe dezinfektimin e shkollave.

Fjalën e mori Kryetari i Bashkise i cili deklaroi se shume shpejte do nisi puna sipas kerkesave qe kane bere drejtoret e shkollave, ndersa gjimnazi do rikonstruktohet ku do behet izolimi, fasada e tj, duhej bere qe gjate pushimeve por nisja me vones ka te beje vetem me proceduren e prokurimit, e cila kerkon kohen e vete per pergatitjen e dokumentacionit perkates, ka te beje dhe me nje bllokim qe na eshte bere nga struktura perkatese qe mbikqyrin procesin e

tenderimit. Komisioneri i Prokurimit Publik jane paraqitur dy ankesa te cilat kane mare kohen e vete per gjykimin e tyre.

Kjo nderhyrje qe do behet me rikonstrukcionin e gjimnazit do e shnderroje ate ne nje godine elitare.

Me leje fjalen e mer Znj. Mimoza Zylyftari e cila deklaroi se:

Fasada eshte e rendesishme, por shqetesuese eshte renia e numrit te nxenesve, ky eshte shqetesimi im ne lidhje me arsimin. Dua te bej prezent dhe disa shqetesime te tjera siç eshte:

Ndriçimi ne zonen poshte spitalit ku nderpritet here pas here energjia elektrike

Hyrja nga posht e spitalit eshte bllokuar nga ferrat dhe mbeturinat, do na vine gjarperinjt ne shtepi. Koshi i mbeturinave eshte hequr tek “Ballat”, Pishat tek varrezat e Deshmoreve jane gati per tu rrezuar, mjafton nje ere e lehte, dhe rrezohen

Fjalen e mori Kryetari i Bashkise i cili deklaroi se do i shohi me prioritet shqetesimet e ngritura. Ai beri me dije se nderprerja e energjise elektrike vjen nga nenstacioni i cili ka nje teknologji me te avancuar por qe do te zgjidhet seshpejti. Problematikat e konstatuara me koshat dhe pastrimin do zgjidhen direkt sapo te kthehen nje pjese e punetoreve te ndermarrjes te cilet kane gene ne malin e Tomorrit gjate diteve te peligrinazhit per te siguruar nje ambient te paster atje.

Me leje fjalen e mer Znj. Mimoza Hysaj e cila deklaroi se: po demtohen pyjet, po priten perdite dhe shiten per dru zjarri ne zonen e Vendreshes se Dyte.

Fjalen e mori Kryetari i Bashkise i cili deklaroi se do dergoje direkt punonjesit e pyjores per tu njohur me gjendjen dhe te marin masa.

Me leje fjalen e mori Z. Pellumb Guri i cili deklaroi se bashkia jep bursa per nxenesit qe jane ne pamundesi ekonomike dhe i kerkoi Kryetarit te Bashkise te trajtohet me burse nxenesi me mbiemer Pasha nga Visocka.

Fjalen e mori Kryetari i Bashkise i cili i kerkoi keshilltarit Z. Pellumb Guri ta drejtoje per tek Kryetari i Bashkise personin ne fjale, te pergatiti dokumentacionin e nevojshem dhe do trajtohet patjeter.

Me leje fjalen e mori Z. Skrdilajd Jaupllari u shpreh se heqja e taksës per blegtorine do te jete ne interes te fermerëve duke qene se eshte nje sektor i veshtire, por edhe ne veshtiresi financiare, mendim icili gjeti mbeshtetje dhe tek keshilltaret e tjere, si Pellumb Guri, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi.

Me leje fjalen e mori Z. Edmond Kalemi i cili beri prezent shqetesimin ne lidhje me nxjerrjen e lejeve te transportit.

Fjalen e mori Kryetari i Bashkise i cili deklaroi se do komunikoje me sektorin perkates dhe te shohim se çfar mund te bejme.

Kryetare e Këshillit ju drejtua keshilltareve keni problematika te tjera -jo

Kryetare e Këshillit deklaroi përfundimin e mbledhjes

Sekretare e Këshillit Bashkiak: Hava Nuellari

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Elsa Petritaj

Këshilltarët që firmosin procesverbalin

Alma Kadiasi _____

Fikret Telha _____

Skerdilajt Jaupllari _____